



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 07.11.2016

Ref.: 1249/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), neni 88 (pika 2 a) i Ligjit mbi Procedurën Administrative (Ligji Nr.02/L-28, datë 22.07.2008), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 46-të, të mbajtur më 31 Tetor 2016, mori:

V E N D I M

I. Riakreditohen programet e studimit të BPrAL Kolegji “Dardania” për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:

- Gjuhë Angleze dhe Studime Amerikane, BA, 180 ECTS (100 studentë për vit akademik);
- Administrim Biznesi dhe Ekonomiks, BA, 180 ECTS, (me specializime: Banka, Financa dhe Kontabilitet; Menaxhment dhe Informatikë; Marketing dhe Ndërmarrësi; Menaxhim i Turizmit; Drejtimi i Përgjithshëm) (160 studentë për vit akademik);
- Administrim Biznesi dhe Ekonomiks, MA, 120 ECTS (me specializim: Banka, Financa dhe Kontabilitet), (60 studentë për vit akademik);
- Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale, BA, 180 ECTS; (180 studentë për vit akademik)
- Shkenca Politike dhe Administratë Publike, BA, 180 ECTS (Specializimi në Administratë Publike) (120 studentë për vit akademik)

II. Nuk riakreditohet programi i studimit:

- Juridik, LLB, 240 ECTS (specializimet Kriminalistikë; Juridik Civil)

III. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.

IV. Obligohet BPrAL Kolegji “Dardania” që deri me datë 1 dhjetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit.

V. Obligohet BPrAL Kolegji “Dardania” që deri me 1 Dhejtor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm te stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji “Dardania” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Juridik	LLB	240	Blerton Sinani, Muazam Halili, Hyreme Gurri
2	Administrim Biznesi dhe Ekonomiks	BA	180	Jeton Mazllami, Izet Zeqiri, Ajtene Avdullahi
3.	Administrim Biznesi dhe Ekonomiks	MA	120	Brikend Aziri, Gjilnaipe Bexheti, Luljeta Sadiku
4.	Gjuhë Angleze dhe Studime Amerikane	BA	180	Florim Ajdini, Majlinda Bregasi, Agim Poshka
5.	Psikologji e Aplikuar dhe Studime Menaxheriale	BA	1820	Lulzim Murtezani, Liridon Korcaj, Ylli Pango

AKA ka organizuar dy vizita në BPrAL Kolegji “Dardania”. Vizita e parë është realizuar më 11.10.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Melita Kovacevic, dhe Prof. Dr. Andrew Goodspeed. Vizita e dytë është realizuar më 17.10.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Kristiina Tonnisson, Prof. Dr. Reinhard Meyers, dhe Prof. Dr. Peter Parycek.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 31 Tetor 2016 ka shqyrtuar aplikacionin e BPrAL Kolegji “Dardania”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me programin e studimit Juridik, LLB, 240 ECTS raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë quar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas Raportit të Ekspertëve, deklarata e misionit të programit është mjaft e përgjithshme dhe nuk ofron asnjë lidhje me Deklaratën e Misionit të hartuar mirë nga Kolegji Dardania. Sipas ekspertëve, përfaqësuesit e programit të studimit nuk kanë ofruar asnjë lidhje të fortë me strategjinë e Kolegjit. Ekipi i Ekspertëve kishte përshtypjen që përfaqësuesit e programit nuk kanë qenë të përfshirë në procesin e hartimit të strategjisë, përkatësisht strategjia e Kolegjit Dardania nuk i është komunikuar stafit të ri të angazhuar në Kolegj. Boshllëku në mes të përfaqësuesve të menaxhmentit dhe programit të studimit ishte mjaft i madh. Rekomandimi i vitit 2013 që programi i studimit të hartojë një identitet të vet; të ri mendohet organizimi i lëndëve, caktimi i lëndëve obligative dhe atyre zgjedhore si dhe specializimet, janë inkorporuar duke zbritur numrin e specializimeve nga 4 në dy, çka mund të shihet si një zhvillim pozitiv, mirëpo përpos kësaj asnjë

ndryshim tjetër apo zhvillim tjetër nuk ka ndodhur – për çka gjatë vizitës ekspertët kanë kërkuar disa herë shembuj të implementimit të rekomandimeve. Aspektet qenësore sikurse aspektet evropiane apo digjitale, të cilat mund të lidhen me dy specializimet, nuk janë zhvilluar. Ekipi i Ekspertëve ka marrë përshtypjen që programi i studimit ka një qasje konservative dhe një kurrikulë të përgjithshme për një program studimit në fushën e juridikut, dhe nëse do të bëheshin pak ndryshime dhe nëse programi ka pak identitet të institucionit, kjo nuk do të binte ndesh me kurrikulën e një programi të përgjithshëm të juridikut. Ekspertët kanë deklaruar se në semestrin e parë dhe të dytë, programi ka 40 kredi për lëndë të përgjithshme jo juridike dhe vetëm 18 kredi për hyrje në parimet e përgjithshme juridike. Kjo strukturë sipas ekspertit nuk është e orientuar kah studenti, të cilët duhet të kenë mundësinë që të kuptojnë shpejtë nëse programi i studimit në të cilin ata janë regjistruar ka qenë vendimi i duhur për ta. Megjithatë, lëndët të cilat nuk i përkasin fushës së juridikut sipas ekspertëve janë zgjedhur rastësisht dhe se ato nuk përbëjnë një profil specifik të programit të studimit. Ekspertët kanë deklaruar se disa nga lëndët e procedurës juridike janë vendosur mjaft vonë ndërsa ato duhet të jenë më afër lëndëve juridike. Ekspertët kanë deklaruar se RVV nuk ofron asnjë informatë për konceptin didaktik. Asnjë dëshmi nuk është ofruar gjatë vizitës për këtë çështje. Stafi akademik kanë deklaruar se ata paraqesin dhe diskutojnë përmbajtjen e lëndëve para studentëve. Ekspertët kanë mësuar nga studentët se ata janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies, megjithatë një koncept i përgjithshëm didaktik mungon plotësisht. Për sa i përket stafit akademik, ekspertët kanë deklaruar se programi i studimit në juridik është një program tradicional me 8 semestra prandaj për këtë arsye nevojitet një grup i fortë i ligjëruesve. Ekspertët kanë mësuar se aktualisht kolegji ka 9 staf akademik me orar të plotë dhe 6 me orar të pjesshëm, çka është afër minimumit për një program të studimit në nivelin bachelor. Proporcioni në mes të stafit akademik full time dhe atij part time është i përshtatshëm. Mirëpo ekspertët kanë përshtypjen që shumica e stafit akademik vijnë në kolegji vetëm për ligjëratat e tyre. Kolegji ka nevojë për një ekip të fuqishëm i cili në mënyrë të vazhdueshme bën hulumtime shkencore dhe bën punë për zhvillimin e programit të studimit, dhe ky ekip sipas ekspertëve nuk ekziston fare. Ekspertët kanë deklaruar se ligjëruesit e renditur në tabelat e lëndëve nuk korrespondojnë me listën e ligjëruesve të programit juridik. Në shikim të parë, lista duket në rregull mirëpo pas një kontrollimi më të detajuar sipas ekspertëve kjo listë tregon se ka shumë pak staf të fushës së juridikut. Sipas ekspertëve, stafi akademik është elementi më i rëndësishëm i vlerësimit të programit dhe parregullsitë në listat e stafit akademik duhet të zgjidhen përpara fillimit të procesit të akreditimit. Megjithatë edhe kjo çështje nuk do të zgjidhte problemin, pasi që sipas ekspertëve problemi kryesor është profili i stafit akademik të caktuar për programin juridik. Ekspertët kanë deklaruar se grupi i ligjëruesve të programit të studimit duhet të fuqizohet, ka nevojë për një menaxhim të saktë dhe për një plan të zhvillimit. Sipas Ekspertëve, aktualisht këto tri elemente duhet të përmirësohen në mënyrë esenciale. Për sa i përket hulumtimit, ekspertët kanë deklaruar se nuk është ofruar asnjë informatë për aktivitetet e hulumtimit dhe se programi nuk ka strategji të hulumtimit fare.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji “Dardania”
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë